



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.31.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMISIONIT TË
PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE PËR VITIN E
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minarale, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Emine Fazliu, i cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Shemsije Llugiqi (Udhëheqëse e Ekipit), dhe Refiçe Morina (Anëtare e Ekipit) nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Ramadan Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	17
5 Qeverisja e mirë.....	18
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	20
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	23
Shtojca III: Letërkonfirmimi	27

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 02/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit- 2017**

Menaxhmneti ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Ne kemi analizuar veprimtarinë e institucionit se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregulloren MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KPMM-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit. Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

KPMM-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2017; dhe
- PVF e përgatitura me kohë dhe të nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHEMNTI I KPMM-së

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, është saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandim lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore, si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

KPMM në përgjithësi ka kontrole të mira në raport me obligimet statutores të saj. Megjithatë, fusha e hyrave si mbikëqyrja e vazhdueshme e bartësve të licencave, ndalimi i operimeve ilegale dhe llogarive të arkëtueshme vazhdon të mbetet fushë sfiduese. Sfidë tjetër për institucionin edhe me tutje mbetet menaxhimi i pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,386,981	1,350,981	1,292,277	1,239,655	1,129,638
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,386,981	1,350,981	1,292,277	1,239,655	1,129,638

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte reduktuar për 36,000€. Kjo diferencë është rezultat i reduktimit të grantit qeveritar me rishikim të buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale për projektin “Defektograf i litarit”. Në vitin 2017, KPMM ka shpenzuar 1,292,277€ apo 96% të buxhetit final, me një rritje prej 2% krahasuar me vitin 2016. Në përgjithësi, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,386,981	1,350,981	1,292,227	1,239,655	1,129,638
Pagat dhe Mëditjet	780,100	780,100	773,366	744,619	712,787
Mallrat dhe Shërbimet	386,281	386,281	354,964	367,258	331,864
Shërbimet komunale	30,600	30,600	22,731	20,932	22,328
Subvencione dhe Transfere	-	-	-	-	13,000
Investimet Kapitale	190,000	154,000	141,166	106,846	49,659

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje nuk kishte ndryshuar nga ai fillestar, dhe se ishte realizuar po thuajse në tërësi (99%);
- Edhe buxheti final për mallra dhe shërbime nuk kishte ndryshime nga ai fillestar. Mjetet financiare të pashpenzuar në fund të vitit ishin 31,317€, si rrjedhojë e mbylljes së zyrave rajonal. Nga mbyllja e këtyre zyrave në fund të vitit kishin mbetur pa u shpenzuar edhe 7,869€ nga shërbimet komunale; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për 36,000€, dhe realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 92%.

3.2 Të hyrat

Në vitin 2017, KPMM kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 30,510,000€, ndërsa janë mbledhur 31,229,252€ që paraqet një tejkalim të planit për 719,252€ apo në masën mbi 2%. Të hyrat janë realizuar nga taksat administrative, gjobat administrative si dhe renta minerare.

Tabela 3. Të hyrat e detajuara sipas llojit (në €)

Përshkrimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Te hyrat sipas llojit	31,229,252	31,206,899	30,141,403
Taksa Administrative	454,370	461,722	292,390
Gjoha administrative	204,406	190,895	149,503
Renta Minerare	30,570,476	30,554,282	29,699,510

Nga tabela e mësipërme vërejmë se trendi i mbledhjes së të hyrat në vitin 2017 është po thuajse i njëjtë me vitin e kaluar (një rritje prej 22,353 €).

Nga testimet tona identifikua çështjet në vijim:

Çështja 1 - Të hyrat nga renta minerare

E gjetura Neni 34 i Ligjit 03/L- 163 për Miniera dhe Minerale i ndryshuar me Ligjin nr.04/L-158, përcakton se- Bartësit e licencave për shfrytëzimin e pasurisë minerare duhet të raportojnë për periudhën përkatëse një përmbledhje të të gjitha rezultateve të aktiviteteve të shfrytëzimit pasurisë minerare, detaje të sakta për tonazhin, vëllimin, përbërjen, shkallën dhe vlerën e mineraleve të prodhuara.

Nga mostrat e testuar është vërejtur se në dy raste, bartësit e licencave për shfrytëzim e pasurisë minerare nuk kanë raportuar mbi aktivitetet e shfrytëzimit, si detaje të sakta për tonazhin, vëllimin, përbërjen, shkallën dhe vlerën e mineraleve të prodhuara.

Rreziku Mos raportimi i rregullt nga ana e shfrytëzuesve të licencës, rrit rrezikun e mungesës së informatave të plota në lidhje me vëllimin e mineraleve të prodhuara si dhe vlerën e obligimeve që e ka secili bartës i licencës ndaj KPMM-së.

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ndërmerren masat e duhura për të shtuar përgjegjësinë dhe efikasitetin e mekanizmave përkatës, për të siguruar informata të plota lidhur me vëllimin e mineraleve të prodhuara dhe aktivitetin e shfrytëzuesve të licencave, ashtu siç përcaktohet me ligjin në fuqi.

Çështja 2 - Të hyrat nga operimet ilegale

- E gjetura** KPMM gjatë vitit 2017 kishte identifikuar 80 raste të operimeve ilegale, ku si rrjedhojë e kësaj, ka shqiptuar 76 kallëzime penale në prokuroritë themelore përkatëse. Për rastet e identifikuara KPMM kishte shqiptuar gjoba në vlerë 605,200€, dhe kishte parashtruar 115 raste /propozim për përmbarrim² në vlerë prej 743,684€ ndaj operueseve ilegal. Përkundër që Inspektorati i KPMM kishte ndërmarrë bashkë-veprime me institucionet përkatëse për ndaljen e operimeve ilegale dhe shqiptimin e gjobave, ne kemi vërejtur se efekti ishte i ulët.
- Rreziku** Vazhdimi i aktiviteteve të operatorëve ilegal mund të shkaktoj mos përdorim të drejtë të pasurive minerale dhe shkatërrimin e tyre. Në anën tjetër, dështimi për të mbledhur gjobat e shqiptuara dhe vazhdimi i praktikave të tilla mund të nxis operuesit ilegal t'i shmangen pagesës për shfrytëzimin e pasurive minerare.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj ndërmarrjen e veprime të menjëhershme koordinuese dhe efikase nëpërmjet organeve shtetërore³, në mënyrë që të ndikojnë në ndalimin e aktiviteteve ilegale. Po ashtu duhet ta analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e gjobave, si dhe të propozoj masa dhe procedura plotësuese që kanë ndikim direkt në ndalimin e operimeve ilegale, inkasimin e borxheve dhe mbrojtjen e pasurisë së vendit.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave (payrollit) që menaxhohet nga MAP dhe MF. Numri i aprovuar i të punësuarve në KPMM ishte 77, ndërsa numri i të punësuarve në fund të vitit ishte 76 punonjës. Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave (punëtorët aktual, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave dhe punëtorët e pensionuar). Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me, rekrutimin, kontratat, trajnimet, avancimin, pushimet etj. Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarrura në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Nga testimet tona identifikuam çështjet në vijim:

² Vlera e përmbarruesve privat përfshin rastet e detyrimeve për përmbarrim të percjellura edhe nga vitet paraprake, ndërsa shqiptimi gjobave janë për rastet e operimeve ilegale gjatë vitit 2017.

³ KPMM, MMPH, MPB, Policia e Kosovës, Prokuroria, Gjykatat, MBPZHR.

Çështja 3 – Zyrtari certifikues

- E gjetura** LMFP nr.03/L048, neni 14 dhe 15, përcakton se çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet të ketë Zyrtarin Certifikues i cili emërohet dhe i raporton Zyrtarit Kryesor administrativ.
- KPMM nuk ka të punësuar zyrtar certifikues, por këtë funksion e kryen kryesuesi i departamentit të administratës i cili menaxhon dhe mbikëqyrë divizionin e logjistikës dhe transportit, divizionin e personelit dhe sektorin gjuhësorë. Në akt emërim është caktuar “Kryesues i Departamentit të Administratës” ndërsa në përshkrimin e detyrave të punës është nënvizuar se vepron edhe si zyrtar certifikues për certifikimin dhe aprovimin e pagesave. Gjatë auditimit kemi vërejtur se kryesuesi i departamentit të administratës i certifikon edhe shpenzimet të cilat i aprovon për divizionet që ka nën mbikëqyrje.
- Sipas KPMM-së, angazhimi i kryesuesit të departamentit si zyrtar certifikues, arsyetohet se në periudhën kur KPMM ishte kompetencë e rezervuar e UNMIK-ut menaxhmenti i atëhershëm ka ngarkuar kryesuesin e administratës me përgjegjësi shtesë me pozitën e certifikuesit dhe menaxhmenti aktual nuk e ka trajtuar si çështje të rëndësisë së veçantë.
- Rreziku** Ushtrimi i funksionit për certifikim dhe aprovim nga i njëjti zyrtar paraqet konflikt interesi dhe nuk jep siguri se procesi i certifikimit është i pavarur dhe profesional.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që të gjendet një zgjidhje e përshtatshme për plotësimin e pozitës së zyrtarit certifikues, sipas LMFP-së.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale ishte 416,881€. Prej tyre ishin shpenzuar 377,695€ apo 91%. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këto kategori përfshijnë shpenzime të udhëtimit dhe akomodimit, shpenzime të qirasë, mirëmbajtje dhe sigurim i automjeteve dhe ndërtesës, shpenzime arsimit dhe trajnimit, shërbime të tjera kontraktuese si dhe shpenzime komunale. Për mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 154,000€. Prej tyre ishte shpenzuar 141,166€ apo 92%. Projektet e realizuar ishin “Avancimin e web faqes-Data Portalit/Gis” dhe “Pajisje të IT-së-Softuer për inspektor”. Për mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që organizata të ketë procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre, si dhe mbajtjen e saktë dhe të plotë të regjistrave të pasurisë, përmes përditësimit të vazhdueshëm të të dhënave.

Pasuria kapitale e KPMM-së mbi 1,000€ ishte në vlerë 942,720€, ndërsa pasuria jo-kapitale nën 1,000€ ishte me vlerë 78,555€ si dhe stoqet në vlerë 108,302€.

Auditimi ynë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi dobësitë e paraqitura më poshtë.

Çështja 4 - Menaxhimi i pasurisë

E gjetura	<p>Në menaxhimin e pasurive kemi identifikuar mangësitë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Me datë 31.01.2017 KPMM kishte marrë vendimi (nr.05/07) për dhurimin e pasurive Qendrës Korrektuese në Lipjan. Ndërsa me vendimin nr. 40/2017 i datës 28.09.2017, KPMM themelon komisionin për vlerësimin e pasurisë jo financiare. Komisioni përkatës pas mbarimit të punës, identifikon pasurit që janë jashtë përdorimit për asgjësim. Ne identifikuam se pasuritë dhuruara si dhe ato të asgjësuar nuk ishin larguar nga regjistrat e pasurisë jo-financiare; • Po ashtu, identifikuam se 20 llaptopa dhe pajisje përcjellëse në vlerë 14,524 edhe pse ishin të regjistruar në SIMFK, të njëjtit ishin regjistruar edhe në sistemin e e-pasurisë. Në këtë rast, pasuria ishte mbivlerësuar për 14,524€.
Rreziku	Mos azhurnimi i regjistrit të pasurisë pas çdo ndryshimi, dhe regjistrimet e dyfishta, nuk na ofron siguri se regjistri i pasurisë është i plotë dhe i saktë, si dhe pasuria e organizatës e pasqyruar në PFV është e mbivlerësuar.
Rekomandimi 4	Kryesuesi i Bordit duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke bërë regjistrimet e duhura dhe larguar nga regjistri gjithë pasurin e dhuruar dhe të asgjësuar në mënyrë që prezantimi i pasurisë në PVF në fund vit të jetë i saktë dhe e plotë.

3.8 Të arkëtueshmet

KPMM ka të deklaruar në PFV shuma të konsiderueshme të LL/A në vlerë 23,220,146€, ndërsa vetëm për vitin 2017 LL/A ishin 3,646,182€. Llogaritë e arkëtueshme përbëhet kryesisht nga renta minerare, taksat administrative dhe gjobat administrative.

Vlen të përmendët se obligimet ndërmarrjes Trepça e cila është nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në vitin 2017 ishin 10,118,246€, ndërsa New Ferronikeli për vitin 2017 kishte obligime 1,447,413€.

Çështja 5 - Rritja e llogarive të arkëtueshmeve

E gjetura Në KPMM vërehet një trend në rritjen e vazhdueshme të arkëtueshmeve nga viti në vit (16% vetëm 2017). Kjo gjendje ishte edhe përkundër që KPMM kishte aplikuar programimin e borxhit, kushtëzimin e lejeve, shqiptimin e gjobave dhe angazhimin e përmbarueseve privat me qëllim të arritjes së rezultateve sa ma të mira, porse këto veprime nuk kishte treguar ndonjë efekt konkret. Për këto çështje ne kemi rekomanduar edhe në vitin e kaluar, mirëpo kjo mbetet edhe më tutje sfidë e KPMM-së.

Rreziku Rritja e të arkëtueshmeve dhe jo efikasiteti në procesin e mbledhjes së të hyrave (borxheve) me kohë vështirëson arkëtimin e tyre. Në periudhën e ardhshme kjo gjendje mund të krijon pakënaqësi për klientët të tjerët, të cilët kryen pagesat me kohë dhe sipas marrëveshjes.

Rekomandimi 5 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj ndërmarrjen e masave të duhura, përfshirë veprimet ligjore në mënyrë që të shtoj efikasitetin në inkasimin e llogarive të arkëtueshmeve.

3.9 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 15,774€, krahasuar me vitin 2016, obligimet e papaguara ishin 7,929€. Pjesa më e madhe e obligimeve të papaguara i takojnë shpenzimeve të telefonisë, mirëmbajtës së ndërtesave, servisimi i automjeteve dhe shpenzimeve për karburant të veturave.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitin 2016, ka rezultuar me shtatë rekomandime. KPMM kishte përgatitur planin e veprimi, në të cilin kishte paraqitur mënyrën se si do t'i zbatoj rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, dy rekomandime janë zbatuar, një ishte në proces të zbatimit, dhe katër nuk ishin adresuar ende. Për më tepër, nga viti 2015, ishin bartur tri rekomandime dy nuk ishin zbatuar, ndërsa një në proces. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 6- Zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake

- E gjetura** KPMM ka zbatuar një proces formal të menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të vitit të kaluar të AP-së, nuk është arritur që plani i veprimit të përmbushet në tërësi dhe disa mangësi të përsëriten nga viti i kaluar. Kjo ka të bëjë me mos raportimet e bartëseve të licencave, vazhdimi i operimeve ilegale, dhe rritja e vazhdueshme e të arkëtueshmeve.
- Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta, të cilat mund të ndikojnë në dobësi në menaxhimin financiar dhe të kontrolleve.
- Rekomandimi 6** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar për adresimin e rekomandimeve të mbetura të vitit 2015 dhe ato të vitit 2016. Ky plan duhet të përcaktojë afatet e arsyeshme kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet në mënyrë sistematike nga menaxhmenti për të siguruar zbatimin e plotë të rekomandimeve.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë përfshinë parimet themelore të llogaridhënies, efektiviteti i kontrolleve, menaxhimi i rreziqeve, pavarësia e auditimit të brendshëm, koordinimi i ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisja e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

KPMM ka përgatitur regjistrin e rreziqeve, duke identifikuar disa rreziqe që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj, po ashtu, pyetësi i vet-vlerësimit pasqyron gjendjen aktuale.

KPMM ka zbatuar disa rekomandime, por ende kërkohet angazhim shtesë në zbatimin e plotë të rekomandimeve.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) përbëhet nga një auditor (Drejtor i NJAB), i cili e kishte të aprovuar planin vjetor dhe strategjik. NJAB kishte përmbushur planin e auditimve, ku për 2017 kishte planifikuar dhe kryer pesë auditime të rregullta. Auditimet e kryera nga NJAB mbulojnë këto dep, si: departamentet e përbashkëta për minera dhe minerale (fushëveprimi 2016/2017), departamenti i financave (fushëveprimi 2017) dhe departamenti i prokurimit (fushëveprimi viti 2017).

Në raportet e auditimit të brendshëm janë dhënë 53 rekomandime. Prej tyre, 30 ishin zbatuar, 15 ishin në proces të zbatimit, ndërsa 8 rekomandime nuk janë zbatuar. Inkurajojmë menaxhmentin të ndërmarrë veprime për zbatimin e plotë të rekomandimeve që dalin nga raportet e NJAB-it.

Po ashtu, NJAB kishte raportuar çdo tre muaj në Njësinë Qendrore Harmonizuese në Ministri të Financave.

Komiteti i Auditimit kishte mbajtur katër takime. Çështjet e ngritura nga raportet e auditimit ishin vlerësuar dhe trajtuar prej tyre, duke nxjerr konkluzione dhe rekomandime për menaxhmentin.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguuar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Nga rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në këtë fushë, mund të konkludojmë se menaxhmenti kishte vendosur një strukturë organizative adekuate, kishte bërë delegimin e detyrave dhe përgjegjësive dhe ishte i informuar për proceset e zhvilluara në kuadër të institucionit.

Departamentet dhe divizionet përgatitin raporte të rregullta drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, i cili po ashtu organizonte takime pune të rregullta me udhëheqësit e njësive, të cilat përcillen me procesverbale.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
3.3.1 Te hyrat	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarrë masa për forcimin e kontrolleve menaxheriale lidhur me licencat, si dhe të siguroj që bartësit e licencave pas skadimit të afatit të kenë fonde të mjaftueshme për rehabilitim e zonave/sipërfaqeve të shfrytëzuara dhe sigurinë ndaj palëve të treta.		Rekomandimi është zbatuar pjesërisht për faktin se është ndërmarr disa masa për rehabilitimin e sipërfaqeve të shfrytëzuar.	
3.3.1 Te hyrat	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj koordinim sa më të mirë ndërmjet sektorit të inspektoratit, si dhe mekanizmave të tjera përkatëse në mënyrë që të ndikoj në parandalimin e aktiviteteve/operimeve ilegale duke siguruar grumbullim të të hyrave dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve (popullatës vendase).			Rekomandimi nuk është zbatuar. Vazhdojnë operimet ilegale.
3.8.3 Trajtimi i Borxheve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj ndërmarrjen e masave të duhura, përfshirë veprimet ligjore në mënyrë që të shtoj efikasitetin në inkasimin e parasë publike.			Rekomandimi nuk është zbatuar.

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që plani i veprimit, duhet të rishikohet duke i analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara dhe të përcaktojë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të mbetura, me anëtarët e stafit llogaridhënës dhe me fokus fillestar në fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.			Të pa zbatuara Rekomandimet e dhëna në fushat kryesore nuk janë zbatuar. Rekomandimet e pa zbatuara ndërlidhen me fushat, si: mos raportimet e bartësve të licencave, vazhdimi i operimeve ilegale dhe rritja e të arkëtueshmeve nga viti në vit.
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se mekanizmat për zbatimin e strategjisë dhe menaxhimin e rrezikut janë vendosur plotësisht dhe operojnë në mënyrë sistematike duke siguruar raportim mujor dhe monitorim të vazhdueshëm të tyre. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të procesit të menaxhimit të rrezikut në mënyrë që të parandalohen rreziqet të cilat pengojnë arritjen e objektivave të organizatës.	Rekomandimi është zbatuar.		

2.3 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë një bashkëpunim efektiv në mes të menaxhmentit, KA-së dhe NJAB-së për të identifikuar shkaqet e kësaj gjendje dhe për të ndërmarrë veprime konkrete për të arritur përfitimin maksimal nga auditimi i brendshëm. Më tej, Komiteti i Auditimit duhet të forcojë rolin e vet në këtë proces, duke e mbajtur menaxhmentin më përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve.	Rekomandimi është zbatuara.		
3.3 Të hyrat	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ndërmerren veprime adekuate për të shtuar përgjegjësinë e raportimit duke ngritur efikasitetin me qëllim të sigurimit të informatave të plota lidhur me sasinë e mineraleve të prodhuara dhe aktivitetin e shfrytëzuesve të licencave, ashtu siç përcaktohet me kornizën ligjore.</p> <p>Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj koordinim efikas ndërmjet mekanizmave shtetërore për të parandaluar plotësisht operimet ilegale. Po ashtu, duhet të shqyrtohet mundësia që inkasimi i gjobave të bëhet përmes përmbaruesve privat si një mekanizëm më efikase në mbledhjen e gjobave, sepse kjo do të ketë ndikim direkt në parandalimin e operimeve ilegale.</p>			<p>Rekomandimi nuk është zbatuar.</p> <p>Kompanitë vazhdojnë të mos raportojnë rregullisht.</p> <p>Rekomandimi nuk është zbatuar.</p>

3.2 Pasuritë	Kryesuesi i bordit duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që proceset e menaxhimit të pasurisë janë transparente dhe bëhen në përputhje të plotë me rregullën për menaxhimin e pasurive, duke harmonizuar gjendjen e pasurive me gjendjen e dalë nga inventarizimi.		Rekomandimi është implementuar pjesërisht, ngase stoqet janë regjistruar dhe 122 artikujt të pa regjistruar janë regjistruar në sistemin e pasuria, ndërsa nuk ishte harmonizuar regjistri i pasurive me regjistrin e inventarizimit.	
3.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryesuesi i Bordit duhet të rishikojë politikat dhe rregulloret e KPMM-së me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke marrë të gjitha masat në pajtim me rregulloret dhe ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk I përmbushin obligimet.			Rekomandimi i pa zbatuar. Vazhdon rritja e llogarive të arkëtueshme.

Shtojca III: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



DATË/A :	04.06.2018
REFERENCË :	
PËR/ZA/TO :	Zyrën Kombëtare të Auditimit
CC :	Musa Shabani – Kryesues i Bordit të KPMM-së
NGA/OD/FROM :	Ramiz Krasniqi – Drejtor, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër e Konfirmimit

Të nderuar/a,

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Raportit Financiar të Komisionit të Pavarur të Minerave dhe Mineraleve për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

REPUBLIKA E KOSOVËS ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DITËMARRËSI/DATE MARRËSI/DATE DATE/TAKED 05. 2018			
Kategoria/Grp. Class/Grp.	ID Numëri/ ID Num.	Nr. Prot. Prot. No.	Shifër Identifikuese/ ID No.
05	401	892	1

REPUBLIKA E KOSOVËS ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE		KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE NEZAVISNA KOMISIJA ZA RUDNIKE I MINERALE INDEPENDENT COMMISSION FOR MINES AND MINERALS
DITËMARRËSI/DATE MARRËSI/DATE DATE/TAKED	NR. PROT. PROT. NO.	SHIFËR IDENTIFIKUESIVE/ ID NO.
01	1761	04/06/2018

z. Ramiz Krasniqi

 Drejtor, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Rr. Armend Daci Nr.1
 Prishtinë, Kosovë
 Tel: +381 (38) 240 252
 Fax: +381 (38) 245 844
 E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
 Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
 Skupština Kosova
 Assembly of Kosovo